

Mehmet HAJRIZI

KONTEKSTI HISTORIK I KRYENGRITJES SË VITIT 1981

Këtë vit po shënohet gjithandej përvjetori i dyzetë i kryengritjes së vitit 1981, si një zhvillim historik, tashmë i fiksuar në memorien tonë kombëtare.

Historia e kombit tonë është sa e lavdishme, po aq e dhembshme, me qëndresën stoike si një populli i vogël, trim e luftarak, por që iu desh të derdhte gjakun lumë dhe të bënte sakrificat supreme të pareshtura për të mbrojtur lirinë, identitetin, kulturën dhe dinjitetin e vet tradicional.

Kryengritja e vitit 1981 në Kosovë u zhvillua në një kontekst historik të vështirë, në rrethana komplekse të brendshme dhe të jashtme.

Rrethanat e brendshme historike të kryengritjes Statusi kolonial i Kosovës

Ashtu siç ishte aneksuar dhunshëm, Kosova mbahej dhunshëm nën sundimin serb dhe jugosllav. Shqiptarët nën Jugosllavinë titiste, ndonëse populli i tretë nga madhësia në Federatën jugosllave, ishin qytetarë të rendit të dytë, thellësisht të diskriminuar

dhe të shtypur e të shfrytëzuar. «Streha e të varfërve të Jugosllavisë», siç e quanin Kosovën, duke qenë koloni, sa vinte dhe e thellonte hendekun me njësitë tjera federale të Jugosllavisë. Gjatë katër viteve para kryengritjes së vitit 1981 në Kosovë, diferenca negative me zhvillimin e Jugosllavisë u rrit më shumë se gjatë gjithë periudhës së pasluftës. Gjatë dhjetë vjetëve (1969-1979), produkti shoqëror për banor në Kosovë nga 34% të vlerës mesatare jugosllave, ra në 28%. Më 1980 numri i të papunëve arrinte në 250.000. Studiuesi Sabit Sylja, ka shkruar: «Në Federatën jugosllave Kosova mbeti rajoni më i prapambetur në të gjithë treguesit ekonomikë. Në vitin 1979 kapaciteti prodhues për banor në Kosovë ishte 7, 2 herë nën nivelin federativ dhe 16 herë nën atë të Sllovenisë. Politika ekonomike e udhëheqjes jugosllave ishte e ndryshme me praktikën që ndiqej në njësitë tjera federative. Ajo mbeti në thelb një politikë kolonialiste» Në analizën e tij, Radovan Vukadinoviq, thotë: «Aktualisht vetëm 200, 000 njerëz (prej popullsisë 1.5 milionë) ishin të punësuar rregullisht; 300, 000 njerëz ishin të papunë dhe 450, 000 ishin në shkollë dhe universitet.»

«Raporti i zhvillimit midis Kosovës dhe Kroacisë në vitin 1971 ishte 1:3, 2 ndërsa shifra e sotme (1981) ka shkuar në 1:7.»

Nga varfëria e thellë, shqiptarët morën rrugët e botës. Gjatë dekadës së tetë të shekullit të kaluar mbi 45,000 kosovarë shkuan në kurbet. Kosova me 4.2 për qind të sipërfaqes dhe 7.1 për qind të popullsisë, përmbante mbi 10 % të të gjitha pasurive natyrore të Jugosllavisë. Si koloni, Kosova shfrytëzohej egërsisht nga Serbia dhe Jugosllavia

Kosova ndodhej në prag të një krize kritike dhe të shpërthimit të revoltës popullore.

Gjatë vitit paraprak të kryengritjes, në Kosovë u zhvilluan 553 procese gjyqësore politike. «Politika shfarosëse serbe e jugosllave kundër shqiptarëve që herët ishte orientuar në shumë drejtime, duke filluar nga diskriminimi i egër që ushtrohej ndaj tyre, me deportimin masiv në Turqi, në Shqipëri, në republikat tjera jugosllave e gjetkë, me shfrytëzimin ekonomik e varfërimin e skajshëm dhe mohimin e të

drejtave elementare demokratike, kombëtare, arsimore e kulturore dhe deri te përndjekja policore, dhuna e terrori sistematik.»

Rezistenca e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (LKSH)

Pas shtypjes së demonstratave të vitit 1968 dhe të përndjekjes së organizatorëve e pjesëmarrësve të tyre, në vitet shtatëdhjetë të shekullit XX, LKSH u organizua dhe veproi në kushte të reja historike. Në rajon dhe në Evropë, vazhdonte stabilizimi i paqes, kurse Jugosllavia me fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar dhe pozitën e saj gjeostrategjike, në dy karriget, Lindje-Perëndim, liderizmin në Lëvizjen e të Paangazhuarve etj., e dëmtonte rëndë çështjen e Kosovës. Personaliteti i shquar intelektual dhe kombëtar i Kosovës, Ukshin Hoti, i cili konsiderohet i zhdukur nga regjimi serb që nga viti 1999, ka shkruar: «Jugosllavia në tërësi ishte vend specifik: strategjikisht e lidhte Evropën me Azinë, Lindjen me Perëndimin, Paktin e NATO-s me Traktatin e Varshavës; politikisht-i ndante dy sistemet globale: të kapitalizmit dhe të socializmit; në pikëpamje të kulturës-i gërshetonte tri religjione (katolicizmin, ortodoksizmin dhe islamizmin) dhe dy civilizime (të Perëndimit dhe të Lindjes).

Ndërkaq, Kosova, jo vetëm që i reflektonte të gjitha këto kundërthënie e ndikime, por i kishte edhe të vetat, specifike: në pikëpamje strategjike- mund të shndërrohej në garnizon të shkëlqyer ushtarak për ruajtjen e vijave të rëndësishme Lindje-Perëndim dhe anasjelltas; politikisht reflektonte vetëqeverisjen me socializmin radikal; në pikëpamje të kulturës-jo vetëm që gërshetonte religjionet dhe civilizimet, por vetë shqiptarët, megjithëse i mbanin ato në vete me shekuj, kishin arritur të mbeteshin të vetes. Mbi të gjitha, Kosova i reflektonte kundërthëniet midis zhvillimit dhe ecjes në ngecje. Për këto shkaqe, pozita e saj strategjike, në literaturën ndërkombëtare politike, e përshkruar si »area of potential crisis«, nuk do të duhej të përkthehej si »hapësirë e krizave potenciale«, por si hapësirë e bombardimit permanent të kundërthënieve dhe të ndikimeve në fjalë». Në plan të brendshëm të Kosovës, fillimi i reformës kushtetuese dhe

kurorëzimi i saj më 1974 krijoi iluzionin se shqiptarët do të barazoheshin me popujt tjerë të Federatës, por me gjithë avancimin e autonomisë në subjekt konstituiv të Federatës, Kosova mbeti në kuadër të Serbisë, duke hyrë në një fazë të re të robërisë, me politikën e dhunës, por të kombinuar me atë të mashtrimit e të iluzionit, ngjashëm me vitin 1908 me revolucionin xhonturk.

Në këto rrethana, riorganizimi dhe vazhdimi i rezistencës së LKSH ishte një domosdoshmëri historike.

Filloi me Grupin Revolucionar të Kosovës (GRK), në programin e të cilit shkruante: «Aspiratat e popullit tonë për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar, janë të vjetra. Lufta e popullit tonë për t'i realizuar këto aspirata përbën faqe të lavdishme të historisë së tij... Populli ynë ka luftuar, lufton dhe është i vendosur të luftojë gjer në realizimin e plotë të këtyre aspiratave». Mjeti final për realizimin e qëllimeve programatike të kësaj organizate do të ishte organizimi i një kryengritjeje të armatosur për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Në vitet vijuese LKSH u fuqizua edhe me një varg subjektsh atdhetare e çlirimtare. Njëri ndër politikanët besnik të regjimit pushtues në Kosovë, Ali Shukriu, ka deklaruar, në një nga mbledhjet e shumta pas demonstratave më 1981 se «Veprimtaria e irredentës në Kosovë, ka qenë pothuajse permanente që nga çlirimi (1945) e deri sot».

Historikisht dihet që LKSH e shekullit XIX, ndonëse luftonte për pavarësi, bënte veprime taktike, duke u fokusuar në zgjerimin e autonomisë së shqiptarëve. Kështu do të ndodhë edhe më 1981, kur LKSH, pa hequr dorë nga kauza e bashkimit kombëtar, taktikisht u përcaktua për programin minimum, Republikën e Kosovës në Federatën jugosllave.

Reforma kushtetuese e vitit 1974

Me kushtetutën e vitit 1974 të pakënaqur ishin shqiptarët dhe serbët, por për interesa diametralisht të kundërta. Shqiptarët, sepse nuk e kishin fituar të drejtën për të qenë të barabartë me popujt tjerë të

Federatës, kurse serbët, se konsideronin që shqiptarët kishin fituar më shumë të drejta se që duhej. Të parët aspironin ta suprimonin statusin e dykuptimshëm, kurse të dytët ta suprimonin tërësisht autonominë e Kosovës. Noel Malcolm shkruan: «Sikur më 1945, edhe me 1974 statusi politik i Kosovës u vendos nga lart.» Serbët që angazhoheshin për një politikë unitariste shtetërore në Jugosllavi, nën hegjemoninë e tyre, nuk ishin aspak të lumtur as me decentralizimin dhe politikën liberale të Federatës. Ekuilibristi Tito insistoi për këto procese, sepse ndjente që Kroacia dhe Sllovenia do të ndaheshin, kurse serbët që i kishte goditur dy herë fuqishëm (më 1966, duke shfuqizuar satrapin Aleksandër Ranković dhe më 1972, duke shuar me mbështetjen e Dragosllav Marković të ashtuquajturën Lëvizje Liberale të Beogradit, të Marko Nikezićit dhe Latinka Perovićit), ishin më të struktur, por jo edhe aq sa ta pranonin barazinë e shqiptarëve. Natyrisht, kompromisi u bë në kurriz të popullit të vogël shqiptar.

Revanshizmi serbomadh dhe periudha pas Titos

Në qarqe të brendshme, por edhe ndërkombëtare, pritej me të drejtë që në periudhën post-Tito, Jugosllavia nuk do të ishte ajo e para vdekjes së tij. Bëheshin parashikime, por edhe projekte nga jashtë e nga brenda për ndryshime dhe madje për prishje të Federatës, për ndërhyrje, për aleanca të interesave të përbashkëta etj. Në dokumentet e Arkivit Kombëtar të Londrës për kryengritjen shqiptare të vitit 1981 gjejmë:

«Si udhëheqësit jugosllavë edhe ata shqiptarë (në Shqipëri, MH) janë të shqetësuar për një kohë të gjatë për kërcënimin sovjetik ndaj regjimeve të tyre dhe mundësinë që BRSS mund të ishte në gjendje të përdorte territorin e palës tjetër si bazë për subversion. Ndërkohë që po afrohej epoka post-Tito, veçanërisht kur Tito u shtrua në spital, thuhet se shqiptarët ishin të shqetësuar se pasardhësit e Titos nuk do të ishin në gjendje t'i rezistonin presioneve sovjetike për të fituar pozitë të favorshme në Jugosllavi. Jugosllavët - të shqetësuar për pasiguritë e vazhdimësisë pas Hoxhës - u përpoqën të

përmirësonin marrëdhëniet me Shqipërinë me qëllim që të kishin një kuptim më të mirë të zhvillimeve aty dhe të kundërshtonin përpjekjet e Moskës për të rritur influencën politike, ekonomike dhe ushtarake në mesin e zyrtarëve shqiptarë.» Dhe më tej: «Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare kanë pësuar kthim të rëndë prapa. Mund të duhen vite që të ndodhin përmirësime. Ka të ngjarë që të dyja palët të presin me durim duke e parë njëra-tjetrën me mosbesim, por duke shmangur një prishje që mund të inkurajojë Moskën për t'u bërë më aktive në Ballkan. Zyrtarët jugosllavë e kuptojnë se Tirana ka aftësinë që të nxisë pakënaqësi dhe trazira në radhët e shqiptarëve etnikë. Kështu, zgjidhja e problemit shqiptar mbetet vendimtare për integritetin territorial të Jugosllavisë dhe për stabilitetin në Ballkan.»

I ngarkuari me punë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Jugosllavi, Lik Seiti, në takim me Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror të PPSH, Enver Hoxha, në Tiranë, më 19 shtator 1970, nga një bisedë që kishte pasur me Fadil Hoxhën, i referon Enverit lidhur me pikëpamjen e tij për periudhën e pas Titos: «Fadili tha që Titua ... që tani sa është gjallë po punon që Federata të mbetet e pandryshuar pas vdekjes së tij, po merr masa që as më vonë të mos dominojë shovinizmi serbomadhi, as të ngrihet konfederata, siç ka pasur zëra, por as të mos jetë Jugosllavia një federatë e përqendruar, ku të dominojnë serbomëdhenjtë. Dhe kësaj pak a shumë po i arrihet. Duke ngritur problemin e udhëheqjes së Lidhjes Komuniste, ai theksoi se tashmë kjo është e sigurt, megjithëse mund të ngjallen forca për ta rrezikuar Federatën.» Pas vdekjes së presidentit të përjetshëm jugosllav, Josip Broz Tito më 1980, nacionalizmi ekspansionist serb po merrte hov me pretendimet e zgjerimit të «Serbisë së Madhe» në shumë teritore të fqinjëve të saj në Federatë. Në kuadër të idesë pansllaviste, ajo ëndërronte të prekte ujërat e tre deteve. Këtë projekt madhor nationalist dhe ekspansionist, shovinistët serbë që më parë e kishin filluar nën flamurin e miteve me Kosovën, kur po përgatiteshin etnshëm për një ofensivë revanshiste kundër autonomisë së saj. Serbia e konsideronte të devoluar qeverisjen autonome në Kosovë, të cilën kinse e kishte dhënë përkohësisht dhe se mund ta kthente kur të donte.

«Pa kaluar as një vit nga Kushtetuta e vitit 1974, Kryesia e RS të Serbisë organizoi një komision për të kundërshtuar zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974 lidhur me statusin e krahinave dhe raportin e tyre me Serbinë» Ky komision në krye me antishqiptarin Dragosllav Markoviq- Drazha, mikun familjar të Slobodan Milosheviqit të ardhshëm, më 1976 hartoi dokumentin e quajtur «Libri i kaltër», për heqjen e autonomisë Kosovës dhe Vojvodinës.

Në një intervistë në prill të vitit 1994, Fadil Hoxha ka dëshmuar: «... 'Librin e kaltër' (1976-1977) udhëheqja serbe me në krye Drazha Markoviqin e kishin përgatitur në fshehtësi së bashku me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Serbisë. Drazha Markoviqi ishte organizator, ideolog dhe ekzekutor i atij projekti antishqiptar kundër Kosovës... Me 'Librin e kaltër', udhëheqja serbe synonte që të rihapte në nivel të ish- Federatës jugosllave diskutimet për heqjen e autonomisë së Kosovës që ishte siguruar me Kushtetutën e vitit 1974.»

Udhëheqja e atëhershme serbe projektonte suprimimin e autonomisë, por njëri nga udhëheqësit e mëvonshëm serb Borisav Joviq, konsideron se ky reagim ishte i vonë, prandaj duhej të parandalohesh kushtetuta e vitit 1974, qoftë edhe me koston e pasojave politike, duke e kundërshtuar Titon e pakundërshtueshëm. Udhëheqja serbe, thotë Joviq «Duhej ta dinte, dhe e dinte, që kjo draft-kushtetutë përfaqësonte fundin e Jugosllavisë dhe një tragjedi për popullin serb... Ata sakrifikuan në heshtje interesat e njerëzve të tyre dhe të ardhmen e vendit të tyre, duke ruajtur pozicionet e tyre politike.» Ky projekt operativ vetëm ishte suprimuar përkohësisht në kohën e Titos, por jo i hedhur në koshin e plehrave të historisë. Thuhej në qarqe të brendshme dhe të jashtme se pas vdekjes së Titos, Jugosllavia do të shembej e shkrëmoqej nga vetë kontradiktat midis njësive konstituive të saj, por mbi të gjitha për shkak të çështjeve të pazgjidhura kombëtare, ndër të cilat më e mprehta ishte ajo e shqiptarëve të robëruar nën Jugosllavi. Për këtë arsye më 1981 procesi i dekompozimit të Federatës nuk filloi sipas parimit nga e lehta drejt së

vështirës, por pikërisht nga më e vështira, më e ndërlikuara, por më e drejta dhe legjitime; çështja shqiptare.

Sipas dokumenteve të deklasifikuara të CIA-s, SHBA qysh më 1973 kanë paraparë që Jugosllavia pas Titos mund të shembej. Është thënë qartë që vdekja e Titos nuk është çështje me të cilën përballet vetëm Jugosllavia, por edhe vende të tjera, midis të cilave SHBA dhe BRSS. Edhe në mars të vitit 1980 CIA, një vit para kryengritjes në Kosovë, kishte paralajmëruar dekompozimin e Jugosllavisë, pikërisht për çështjet kombëtare. Madje edhe lideri komunist shqiptar, Enver Hoxha në librin e tij «Imperializmi dhe revolucioni» e parashikonte këtë proces në Jugosllavi, por edhe mundësinë e intervenimit ushtarak të BRSS aty. E pra, LKSH ishte në korrent të këtij oguri.

Në këtë gjendje të fakteve, Kosova nuk duhej të priste e qetë këtë proces, sepse ndarja e republikave dhe prishja e Federatës, do ta linte Kosovën nën Serbi, siç e la më vonë, e cila do ta shtypte akoma më egërsisht duke i pasur duart e lira nga Federata, njësi konstituive e së cilës ishte edhe Kosova. Të mbetet Kosova tërësisht nën mëshirën e Serbisë në fillim të viteve tetëdhjetë do të ishte shumë më e rrezikshme, sesa në fund të asaj dekade, kur në plan të brendshëm, por akoma më shumë në atë rajonal e ndërkombëtar, kishte ndërruar shumë situata, nga erërat transformuese që po frynin dhe nga rrënimi i Murit të Berlinit.

Më 1981, shpërthimi i kryengritjes shqiptare erdhi si një digë ndaj proceseve retrograde të këtyre përgatitjeve finale të shovinizmit serb. Një popull i tërë, i zgjuar kombtarisht, i frymëzuar nga tradita dhe LKSH e kohës, u ngrit në këmbë për të mbrojtur jetën dhe për të kërkuar të drejtat legjitime kombëtare të tij. Përmasat e saj shpërthyen kufijtë jugosllavë, duke bërë jehonë edhe në skajet më të largëta të globit.

Siç i ndiejnë minjtë në thellësinë e tokës dridhjet tektonike, edhe klasa politike jugosllave e atëhershme e hetonte tërmetin e ardhshëm politik nën këmbët e veta, prandaj e hakërruar u hodh me të gjithë arsenalin e mekanizmave shtypës kundër një populli të vogël që

tashmë kishte vendosur t'i këpuste prangat e robërisë dhe t'i hapte vetes perspektivën e lirisë.

Gazeta gjermano-perëndimore «Frankfurter Allgemeine» e datës 9 prill 1981, ndër të tjera shkruante: «Kur u vjen uji deri në fyt, diktaturat fashiste të Amerikës Latine dhe vetadministrimi jugosllav reagojnë siç duket në mënyrë bukur të ngjashme.» Jugosllavia hiqej e befasuar, kur e dinte çfarë po zihej në kazanin e saj. E dinte realitetin e një populli të tërë të hallakatur në atë kreaturë që po vuante diskriminimin kombëtar dhe robërinë koloniale. E dinte se Kosova kishte një lëvizje klandestine të pashuar, të cilën kurrë nuk kishte arritur t'ia asgjësonte, sepse burimin e kishte nga vetë populli i saj.

Shqipëria dhe Kosova

Shqipëria me atë fuqi që kishte, doli në mbrojtje të të drejtave të Kosovës në plan kombëtar dhe ndërkombëtar. Nëpërmjet të mjeteve të saj të informacionit, të politikës dhe diplomacisë zyrtare, të bashkëpunimit kulturor, arsimor e shkencor me Kosovën etj., Shqipëria mbronte të drejtat legjitime të shqiptarëve nën pushtim, ndihmonte emancipimin e kosovarëve dhe ngritjen e ndërgjegjes kombëtare. Shqipëria vuri në funksion të mbështetjes së kryengritjes së vitit 1981, institucionet shtetërore, shtypin, radiotelevizionin, emisionet e rregullta radiofonike në dhjetëra gjuhë të huaja, diplomacinë në katër anët e globit, duke përhapur kudo në botë të vërtetën për çështjen e pazgjidhur shqiptare dhe për kërkesat legjitime të Kosovës. Në ditarin e tij politik, më 11 prill të vitit 1981, udhëheqësi i Shqipërisë, Enver Hoxha shkruante: «...ne do t'i mbrojmë vëllezërit tanë kosovarë deri në fund, në të drejtat e tyre dhe tonat të përbashkëta. Shqiptari nuk e duron robërinë, ai e di dhe e ka provuar se liria fitohet me gjak dhe me luftë.»

Gjatë dhe pas kryengritjes së vitit 1981, në Shqipëri nga kreu politik dhe ushtarak u hartua plani i emërtuar «Shpërthimi» për ndërhyrje të forcave shqiptare në Kosovë, në rast të shkallëzimit të dhunës, ose të shpalljes së administrimit ushtarak, si më 1945. Që

atëherë kishte filluar ristrukturimi i ushtrisë, nga korpuset në divizione, që i jepte asaj, përveç funksionit të mbrojtjes edhe atë të mësymjes. Në një intervistë Fadil Hoxha, zyrtar i lartë i Kosovës dhe i Jugosllavisë, ka thënë: «Pas vitit 1981, situata e jonë u keqësua. Unë isha në Kryesinë jugosllave edhe tri vjet, por në kohën time serbët dhe aleatët e tyre kërkonin që në Kosovë të vendoset diktatura dhe administrimi ushtarak, kërkesë kjo e cila megjithatë nuk kaloi, pavarësisht shkallës së lartë të dhunës shtetërore serbe e jugosllave mbi popullin e Kosovës...»

Tirana zyrtare, sipas shumë studiuesve të huaj, nga viti 1981, iu përkushtua më shumë interesit kombëtar, sidomos në Kongresin VIII të PPSH. E shqetësuar me ndikimin e Shqipërisë në Kosovë dhe me mbështetjen që i bënte asaj, udhëheqja e lartë partiake në Beograd ishte alarmuar seriozisht.« Studiuesi Sabit Syla në shkrimin e tij »Qëndrimi i Republikës së Shqipërisë ndaj demonstratave në Kosovë me 1981«, të datës 21 mars 2021, thotë: »Demonstratat e vitit 1981 patën jehone sidomos në Republikën Popullore të Shqipërisë, e cila jo vetëm që vlerësoi kërkesat e demonstruesve, por dënoi pa mëdyshje dhe me vendosmëri qëndrimin e autoriteteve jugosllave ndaj tyre... Qëndrimet e Shqipërisë bënë efektin e tyre në Kosovë, influencuan pozitivisht, sadopak penguan vrullin gjakatar të ushtrisë jugosllave dhe të UDB-së, si dhe në një masë bënë që edhe opinionin e diplomacia botërore të dënonin qëndrimet politike dhe veprimet barbare të jugosllavëve në Kosovë...Tirana duke demaskuar politikën shoviniste serbe, goditi rëndë prestigjin e Jugosllavisë, brendapërbrenda saj dhe në arenën ndërkombëtare.

Duke qenë fqinje, Shqipëria dhe Jugosllavia përveç kontradiktave të thella, ia kishin nevojën njëra-tjetrës në rrethana të caktuara historike. Në dokumentet e Arkivit Kombëtar të Londrës, është edhe ky konstatim i kohës së kryengritjes shqiptare: “Siç duket, dy vendet nuk dëshirojnë t'i shtyjnë gjërat në ekstrem...Jugosllavia për shkak të frikës së saj se një Shqipëri plotësisht e izoluar, mund të kërkojë pas periudhës së Enver Hoxhës mbrojtjen e sovjetikëve dhe Shqipëria nga ana e saj, për shkak të nevojës së saj jetësore që të

mbulohej nga një shtet politikisht i qëndrueshëm tampon kundrejt BRSS-së. Nga ana tjetër, nuk ka tregues se trazirat në Kosovë janë provokuar nga Bashkimi Sovjetik.

Rrethanat e jashtme historike të kryengritjes Lufta e Ftohtë dhe Detanta

Lufta e Ftohtë ishte kontradikta e fortë midis dy blloqeve, ai i Perëndimit me në krye SHBA dhe i Lindjes, i drejtuar nga BRSS. Kishte filluar menjëherë pas LDB për dominim të sferave të interesit dhe ka zgjatur rreth gjysmë shekulli. Është karakterizuar me garën e ethshme të armatimit strategjik dhe nuklear. Ukshin Hoti ka shkruar: «Tani, Franca dhe Britania e Madhe e humbën primatin e tyre udhëheqës në Evropë, por edhe në botë, pas gati dy shekuj avangarde. Këto dy shtete jo vetëm që humbën rolin udhëheqës, por gjatë kësaj periudhe të Luftës së Ftohtë i humbën edhe të gjitha shtetet kolonizuese që i kishin në posedim. Rolin e tyre e morën dy superfuqi të reja, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, të cilat gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX do të luajnë rolin kryesor dhe vendimtar në marrëdhëniet ndërkombëtare në botë.»

Në këtë gjendje të tendosur ndërkombëtare, fillimi i një lufte në Kosovë, për më tepër pa armatimin minimal, ishte një ndërmarrje e paparashikueshme.

Megjithatë, brenda kësaj periudhe kishte edhe një proces shtendosjeje midis dy superfuqive, që nga frëngjishtja u quajt Detantë, e cila kishte filluar nga mesi i viteve gjashtëdhjetë dhe zgjati deri në fillim të vitit 1980. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik i trajtonin me bisedime tensionet, duke arritur më 1972 marrëveshjen për mospërhapjen e armatimit strategjik dhe duke zbutur raportet e acaruar midis tyre. Megjithatë vazhdonin konfliktet, sidomos midis aleatëve të dy superfuqive, si në Azi dhe në Lindjen e Mesme. Në këtë mezofazë, BRSS ndërhyri ushtarakisht në Çekosllovakia, si provë mbase për të sulmuar edhe Jugosllavinë dhe Shqipërinë. Përveç përpjekjeve për ndikim të BRSS në Ballkan dhe atyre për shpërbërjen

e Federatës jugosllave, në këtë rajon të quajtur «Fuqi baroti» vatra krize ishin edhe raportet Turqi-Greqi, të prishura që nga 1974 për shkak të Qipros, të cilat reflektoheshin edhe në vendet përreth, pastaj mundësia që edhe në Maqedoni të kishte zhvillime të ngjashme me ato në Kosovë, nga elementi probullgar etj.

Është përfolur shumë dhe gjatë, madje edhe sot nga dofarë intelektualësh për implikimin rus në kryengritjen e vitit 1981, por kurrë nuk u dhanë prova. Të kihet parasysh që BRSS atëherë ishte shumë i preokupuar me Poloninë dhe Afganistanin, por mbi të gjitha, LKSH e kishte në kontroll kryengritjen, duke e drejtuar, duke i dhënë karakterin çlirimtar kombëtar, paqësor dhe demokratik. Megjithatë, kryengritja nuk mund të ishte pa asnjë ndikim nga zhvillimet jashtë Kosovës. Siç thoshte Ukshin Hoti: «Edhe nga aspekti praktik-politik, ngjarjet e vitit 1981 nuk u zhvilluan tërësisht jashtë mundësive të ndikimeve të proceseve ndërkombëtare», si ato brenda vetë bllokut socialist, «Solidariteti» («Solidarnost») në Poloni, kontestimi i teorisë së Brezhnjevitet për sovranitetin e kufizuar, luftërat nacionalçlirimtare të popujve të robëruar etj. Ndikimi i Shqipërisë ishte gjithashtu shumë i fuqishëm në Kosovë. Autorët Syla-Kaba, kanë shkruar: «... çështja e Kosovës ka dy rrënjë kryesore, një rrënjë të gjatë dhe të thellë që vazhdon prej shekujsh në rivalitetin dhe armiqësinë serbo-shqiptare, dhe një rrënjë relativisht më të re, por gjithsesi të guximshme në zhvillimet socio-ekonomike në Kosovë në Jugosllavinë e pasluftës.»

Konferenca e Helsinkit

Në sfond të Detantës, Fuqitë e Mëdha nisën bisedimet për kontrollin e armatimit, sidomos të atij nuklear. Kjo ishte pika kulmore e shtendosjes së viteve shtatëdhjetë, që bazohej në bashkekzistencë paqësore të dy blloqeve të armiqësuar.

Më 1 gusht 1975 kryeministrat e 33 vendeve evropiane (refuzuan Shqipëria dhe Andora), si dhe përfaqësues të ShBA e Kanadasë, nënshkruan në Helsinki aktin përfundimtar të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE), qëllimi i së cilës

ishte stabiliteti dhe siguria në Evropë. Shtetet u zotuan për bashkëpunim ekonomik, kulturor e shkencor, por edhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Konferenca i bënte të paprekshëm kufijtë në Evropë, legjitimonte kontrollin e sovjetikëve ndaj Evropës Lindore dhe njihte vlerat perëndimore me liritë themelore, si liria e lëvizjes, e informimit etj. Sidoqoftë, Konferenca solli një frymë shtensionuese midis Lindjes dhe Perëndimit. Pas KSBE-së, në bllokun socialist pati shumë disidentë. KSBE më 1994 u shndërrua në OSBE (Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit Evropian).

Në këtë kohë shtendosjeje ndërkombëtare, Lëvizja e të paangazhuarve humbi në peshë dhe bashkë me të edhe Jugosllavia, e cila nuk e kishte më rolin ekuilibruer si më parë që për pasojë dëmtohej politikisht dhe ekonomikisht.

Fundi i viteve shtatëdhjetë i solli krizë të thellë Detantës, e cila kishte filluar që në kulmin e saj në mesin e dekadës, kur BRSS e theksonte paprekshmërinë e kufijve, kurse SHBA të drejtat e njeriut. BRSS kishte marrë një garanci joformale nga Kisingjer (Henry Kissinger) se nuk do të insistohej në të drejtat e njeriut, por pastaj për administratën e Xhimi Karter nuk vlente, sepse në bazë të të drejtave të njeriut e ndërtoi politikën e jashtme të SHBA-ve.

Kjo politikë u ndie edhe në Jugosllavi, me fushatën e shumë organizatave në rastin e grevës së Mihail Mihailovit.

Ndërkombëtarizimi i çështjes shqiptare dhe solidarizimi i jashtëm

Për çështjen e pazgjidhur shqiptare shkruhej gjerësisht në shtypin botëror dhe mbi të gjitha, filloi të lëvizte diplomacia ndërkombëtare, por edhe politika, duke përfshirë Kongresin Amerikan dhe Parlamentin e Bashkimit Evropian.

Në organet e shtypit, në radio e televizion, në agjencitë kombëtare të lajmeve të vendeve të ndryshme, si Gjermania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Franca, Italia, Turqia,

Austria, Suedia, Danimarka, Greqia, Spanja, Portugalia, Kanadaja, Meksika e deri te Zelanda e Re, u shkrua dhe u fol kundër politikës jugosllave ndaj shqiptarëve, duke i mbështetur kërkesat e kryengritjes shqiptare. Shumica prej medieve pasqyronin politikën zyrtare të vendeve përkatëse. Nga mediet ndërkombëtare që e trajtuan çështjen e Kosovës gjatë kryengritjes, ishin edhe: «Nju Jork Tajms», «Gardian», «Reuter», «Ekonomist», «Frankfurter Allgemeine Zeitung», «Figaro», «Corriera de la sera», «Le kotidien de Paris», «AFP», «Le kotidien Rome Alpe», «Noje Cait», «Svenska dagbladet», «Xhumhuret», «The Times», «Suddeutsche Zeitung», «Berliner Morgenpost», Radio Rias, «Der Tagesspiegel», «Der Spiegel», «Sud Kurier», «Nyrnberger Nachriten», «Neue Kronenzeitung», «A.C.Tagblatt fyr Wsterajh», «Di Prese», «Kurir», «Republika», «Boston Globe», «Herald Tribjun», «Njuz Herald», «Krisçën sajëns monitër», «Le Zhurnal», «Internejshenell dejli njuz», «Bashkent», «Devrim», «Hyrrjet», «Baresh», «Apojevmatini», «Di velt», «Dages Nyheter», «To Vima», Buletini i Agjencisë së lajmeve të Greqisë, Radio Athina, «Il Manifesto», «Tempus», «Avui», «Socialistik daglad», «Aftenbladet», «Noje Zyriher Cajtung», Radio Berlini Perëndimor, «L'Umanita», «Vanguardia Obrera», «Roter Morgen», «Pipëlls Kanada Dejli Njuz», «Pipëlls Vois», e të tjera.

Në gazetën «The economist» të 2 tetorit 1981, në shkrimin me titull Fitol shpërthyes në Ballkan, Një koncesion për Kosovën sot mund t'i kursejë Jugosllavisë një shpërthim më të madh nesër, thuhet: «Një periudhë e gjatë represioni dhe rezistence në Kosovë mund të ishte fitili që shkakton një shpërthim më të gjerë. A nuk do të ishte më mirë për Jugosllavinë që t'i lejonte kosovarët të kenë po ashtu Republikë, të cilën duket se e dëshiron shumica?»

Fillimi i çmontimit të bllokut socialist

Me të ardhur në Shtëpinë e Bardhë në janar të vitit 1981, Ronald Regan i dha fund Detantës.

Jugosllavia e nisi dekadën e re me probleme të rënda ekonomike, politike dhe me vetë sistemin e brendshëm. Për pasojë, as në plan ndërkombëtar nuk ishte më mirë. Fill pas vdekjes së Titos, të gjitha njësitë e Federatës i hapën çështjet e veta specifike. Serbia kishte pritur këtë rrethanë që ta kthente pozitën e dikurshme në krahinat e saj, sipas dokumentit «Libri i kaltër», por edhe sipas ideve të akademikut Dobrica Qosiq, që më 1968.

Pas Luftës së Ftohtë dhe Detantës në plan global, në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjetë nis shthurja e të ashtuquajturit kamp socialist. Kishte filluar me «Solidaritetin» («Solidarnost») e Polonisë, për të tronditur fuqishëm gjithë bllokun e Evropës Lindore dhe me kryengritjen shqiptare që lëkundti themelet e Jugosllavisë. Shtetet ish-socialiste po transformoheshin me shpejtësi.

Blloku socialist karakterizohej me luftën për çlirim nga ideologjia komuniste, me diktaturat e vendosura prej kohësh në vendet e tij, por paralelisht popujt me ndjenjën e ndrydhur kombëtare deri atëherë, përpiqeshin të fitonin pavarësinë kombëtare, shtetin nacional dhe sovranitetin e plotë.

Faktorët frenues dhe faktorët favorizues të çështjes shqiptare

Në kontekstin historik të kohës, çështja kombëtare e Kosovës ndodhej përballë disa faktorëve ndikues, të brendshëm dhe të jashtëm. Këta faktorë mund të ndahen në dy grupe; në faktorë frenues apo pengues dhe në faktorë shtytës, lehtësues e favorizues.

Faktorët frenues

Vetë Kosova i kishte faktorët e saj objektivë, por jo ata subjektivë të përgatitur për të rezistuar me argumentin e forcës, kryengritjen e armatosur.

Nga ana tjetër, politika e Beogradit nuk lejonte asnjë kompromis për barazinë e shqiptarëve me popujt tjerë të Federatës.

Fadil Hoxha ka thënë: «Tito dhe Kardeli, të cilët po ashtu nuk kanë qenë për Kosovën republikë, me një takim më kanë thënë shkurt dhe trup:

»Çka po ju duhet republika? Të jeni të kujdesshëm...Kështu më kishte tërhequr vërejtjen Tito. Pastaj, te ne sinjerisht, edhe vetë ne si udhëheqje e Kosovës nuk ishim aq të nxehtë për republikë...« Eduard Kardel i kishte thënë Fadil Hoxhës: »Shiko Fadil, Serbia është republika më e madhe dhe me të nuk mund të prishemi për shkak të Kosovës«, kurse Vladimir Bakariqit i kishte thënë gjithashtu »Ne sllovenët nuk mund të prishemi me Serbinë për arsye të çështjes së Kosovës«. Ndërkaq, Mahmut Bakalli, ish-udhëheqës i komunistëve të Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ, në një intervistë të vitit 2005, por të botuar pas vdekjes, dëshmon se më 1974, në përfundim të bisedimeve për kushtetutën, i kishte paraqitur Titos në Brione kërkesën e Kosovës që të shkëputej nga Serbia, në këtë mënyrë: »I thashë, neve na nevojitet të udhëhiqemi vetë! Na nevojitet t'i udhëheqim vetë financat, bankat, ekonominë, arsimin, shëndetësinë, kulturën, shërbimin sekret... dhe të bëhemi sikur republikat e tjera të Jugosllavisë, pra duam të vetëqeverisemi. A e di çfarë më thotë ai?! Mirë bre, shkruaj të gjitha këto si propozim për kushtetutën e re. Unë i thashë: Po, por po qe se unë i shkruaj këto që t'i thashë, atëherë del pikërisht ajo për të cilën ti po thua se je kundër - del se Kosova është republikë, e unë s'po dua të hy në konflikt me ty. Përgjigja e tij është kjo: A mund të gjejmë një kompromis?! Ta lëmë në preambulë se formalisht jeni në përbërjen e Serbisë, por jo pjesë përbërëse, por në përbërje të Serbisë. Preambula është pjesë hyrëse e kushtetutës, por jo pjesa normative. Në pjesën normative shkruaj të gjitha këto që m'i the tani! Unë thashë: mirë, këtë do ta bëj! Ai më tha se më shumë nuk mund të bëjmë, sepse tash për tash raporti i forcave është i tillë që mund të ma prishin Jugosllavinë forcat shoviniste serbe. Unë është dashur t'i besojta Titos! Kam besuar se Tito nuk po më mashtron, nuk po më nënçmon dhe është e vërtetë kjo që po më thotë... » Josip Broz Tito, po i përsëriste kështu Mahmut Bakallit ato që i kishte thënë Enver Hoxhës njëzet e tetë vjet më parë, kur ky i kërkonte t'ia kthente

Kosovën Shqipërisë, sepse padrejtësisht ia kishin shkëputur nga trangu.

Konferenca e Helsinkit favorizonte rezistencën ideologjike brenda bllokut komunist, por shqiptarët nën Jugosllavi ishin të shtypur, jo pse ishin të majtë a të djathtë, demokratë apo jo, por për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare dhe të trevave të begata që i trashëgonin që nga parahistoria. Ndryshe nga aspirimi i vendeve të bllokut socialist për të drejtat themelore të njeriut, në Kosovë luftohej për të drejtat e munguara kolektive dhe kombëtare. Këtu vepronin më shumë parimet e luftës nacionalçlirimtare, si vend i pushtuar, sesa për një sistem tjetër ideologjik. Te libri i cituar i studiuesve Syla dhe Kaba, në dokumentet e Arkivit Kombëtar të Londrës lexojmë: «Nacionalizmi shqiptar është agresiv dhe i fortë dhe tenton të vërë bashkimin kombëtar përpara çështjeve të lirisë personale apo të mirëqenies materiale dhe kulturore. Në një shtet emri i të cilit do të thotë »toka e sllavëve të Jugut« shqiptarët janë ndoshta me përkufizim të jashtëm, dhe duke pasur parasysh vështirësitë e tjera të pranishme politike, sociale dhe ekonomike, mund të ketë gjithnjë rritje të ndjenjave në mesin e shqiptarëve të Jugosllavisë se e ardhmja e tyre qëndron në Tiranë.»

Konferenca e Helsinkit përbënte pengesë për çështjen e pazgjidhur shqiptare me paprekshmërinë e kufijve ekzistues të Evropës. Mbase kjo ishte njëra nga arsyet që Shqipëria nuk ishte pjesëmarrëse e Konferencës as nënshkruese e dokumentit finale të saj. Kufijtë e vendosur padrejtësisht, kombin shqiptar e kishin ndarë në gjashtë pjesë. Megjithëse Helsinki nuk e përjashtonte ndryshimin e kufijve, por vetëm me marrëveshje, Serbia kurrë nuk do të pranonte në mënyrë paqësore të ndryshonte kufijtë në kuptimin e humbjes së Kosovës. Ajo madje as sot nuk po e pranon, me gjithë humbjen e luftës më 1999.

Lëvizja shqiptare edhe pse më 1981 e kishte në program Republikën brenda Jugosllavisë, kurrë nuk arriti qoftë edhe vetëm të bisedonte me udhëheqjen zyrtare shqiptare të Kosovës, pa le më të bënin çfarëdo koordinimi. Udhëheqësit zyrtarë shqiptarë në Kosovë,

më shumë nga shantazhi dhe interesi meskin, sesa nga bindja, u pozicionuan kundër kryengritjes dhe LKSH, duke u bërë pjesë e frontit dhe agjendës së Beogradit. Ata më 1981 mund ta luanin rolin e Qeverisë së Kongresit të Lushnjës kundrejt Luftës së Vlorës, me të cilën ishte e lidhur dhe e implikuar, por hiqej si e tërhequr, për shkak të faktorëve ndërkombëtarë, por në Prishtinë «qeveria» mujshare u vërsul egërsisht kundër kryengritësve. Ish-shëfi i Lidhjes Komuniste në Kosovë, Mahmut Bakalli, në një intervistë ka thënë: «Ali Shukriu, Kolë Shiroka, Sinan Hasani etj., pas ngjarjeve të vitit 1981 këta tre dhe disa kadro të tjerë, thua se mezi pritën ato trazira, dhe u vunë shumë lehtë në funksion të politikës së Serbisë, si kuislingë të saj, për ato vepra dhe për atë kohë sa i nevojiteshin Serbisë» Kaqusha Jashari, ish-zyrtare e lartë në nomenklaturën komuniste në Kosovë, në një emision televiziv më 28 shkurt 2021 ka thënë se Serbia ishte në ofensivë, sidomos pas vitit 1981, duke shfrytëzuar «kundërrevolucionin». Serbët jo vetëm luftonin formalisht kadrot shqiptarë, por përdornin edhe vetë shqiptarët kundër njëri-tjetrit, duke filluar nga Mahmut Bakalli, Xhavit Nimani pastaj deri te Fadil Hoxha, të cilët shkonin nga skena pa asnjë solidaritet nga kolegët. Nuk e mbajtën njëri-tjetrin, nga shantazhi, por edhe nga joshja. Pothuajse kurrkush nuk e kundërshtoi Millosheviqin në Fushë- Kosovë, me ndonjë përjashtim.

Ndër faktorët frenues, por kurrë ndalues ishte edhe represioni i egër që ushtrohej ndaj popullit shqiptar në përgjithësi dhe ndaj LKSH në veçanti. Represioni ekstrem i regjimit, shtypja e egër e çdo përpjekjeje për të drejta, madje edhe ndalimi me ligj i lirisë elementare të fjalës, e bënte shumë të vështirë organizimin çlirimtar dhe qëndrueshmërinë e tij edhe kur bëhej në kushte të konspiracionit të thellë.

Siç ka shkruar Noel Malcolm, populli shqiptar nën Jugosllavi shikohej me dyshim, si kolonë e pestë potenciale e tradhtarëve. Nga të gjithë të burgosurit politikë në Jugosllavi, 90 për qind të tyre i përbënin shqiptarët. Ndaj të burgosurve politikë shqiptarë aplikoheshin masa të veçanta dhe diskriminuese penale.

Gjatë viteve 1981-1990 në Kosovë policia dhe ushtria jugosllave kanë vrarë 183 veta (prej tyre 16 fëmijë), dhe kanë plagosur me armë zjarri 616. Në një dokument «tepër rezervat» të institucioneve represive të regjimit, të datës 8 qershor 1982 thuhej se gjatë dy muajve do të organizoheshin 44 procese gjyqësore. Vetëm gjatë kryengritjes së vitit 1981 dhe fill pas saj janë vrarë, apo mbytur në burg 15 vetë, kurse janë plagosur me armë zjarri rreth 1000 demonstrues. Janë shqiptuar gjithashtu 50 shekuj dënim në gjykatat e regjimit pushtues. Ndërkaq, në polici u trajtuan mbi 700.000 qytetarë, ose çdo i treti banor i Kosovës. Gjatë viteve 1945-1990 në ish-Jugosllavi shqiptarët mbajtën për veprimtari çlirimtare rreth 667 shekuj burgim.

Faktorët favorizues

Në fillim të dekadës së nëntë të shekullit XX, kur ndodhi kryengritja në Kosovë, në skenën botërore vazhdonte rendi botëror bipolar, nën udhëheqjen e dy superfuqive, SHBA dhe BRSS, me tendencën e dukshme të mbisundimit të SHBA, për ta zëvendësuar vetëm pas 8-9 vitesh bipolarizmin me unipolarizëm. Fuqizimi i SHBA si superfuqi e vetme në botë dhe i aleatëve të saj, ishte fat dhe rrethanë përcaktuese për të ardhmen e lirë e të pavarur të Kosovës.

Në rast të shembjes, Jugosllavia nuk do t'u shmangej luftërave, siç nuk iu shmang, prandaj Kosova duhej të përgatitej që edhe ajo të merrte armët në një rrethanë të re të dobësimit ushtarak të Serbisë.

LKSH, pavarësisht goditjeve, ishte e gjallë dhe po forcohej çdo ditë. Ashtu siç kishte ndikuar gjatë dekadës së fundit në përgatitjen e kryengritjes, edhe kjo në mënyrë dialektike kishte ndikuar në forcimin e saj.

Fuqizimi i pandalshëm i organizimit profesionist çlirimtar dhe zgjerimi i tij në progresion gjeometrik, u bënë faktorë shprese dhe besimi i fitores mbi robërinë. Zyrtari i lartë jugosllav, Vladimir Bakariq thoshte se «Dikush u ka prirë në mënyrë shumë profesionale këtyre demonstratave dhe është vështirë të thuhet se një Kosovë

relativisht e prapambetur ka mundur të japë një nivel aq të lartë të organizimit sikurse ka qenë atje. Pra, jo në linjën komuniste, por në linjën antikomuniste».

Gazeta franceze «Figaro» e 30 qershorit të vitit 1981, në një artikull për Kosovën prekte qëllimin themelor programatik të demonstratave: «Popullsia e saj shpresonte dhe parashikonte një republikë të Kosovës të pavarur dhe të barabartë me republikat e tjera jugosllave. Që nga kjo kohë është shënuar në këtë krahinë lindja dhe rritja e një korrenti të favorshëm për pavarësi».

Intensifikimi i përpjekjeve të Shqipërisë për Kosovën, në këtë kohë, u bë krah i LKSH. Njëri nga zyrtarët e lartë të Sektorit të Propagandës me Botën e Jashtme (Sektori i Kosovës) në KQ të PPSH, Kristaq Porodini, duke iu referuar marrëdhënieve shqiptare- jugosllave të fillimit të viteve 70, ka thënë: «Shteti shqiptar, qysh në fillim të viteve '70, e forcoi punën në drejtim të Kosovës duke i dhënë përparësi përmirësimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë, veçanërisht pas aprovimit të Kushtetutës Jugosllave të vitit 1974, në të cilën shqiptarët e Kosovës fituan më shumë të drejta si Krahinë Autonome në kuadër të Federatës jugosllave. Avancimi i marrëdhënieve midis dy shteteve, që u aprovua nga të dyja palët, bëhej nga pozicione të kundërta politike.» Lëvizja Kombëtare i shfrytëzoi në të gjitha aspektet këto situata të reja dhe favorizuese historike, pa rënë asnjëherë viktimë e truceve politike.

Shqipëria bënte planin «Shpërthimi» të ndërhynte ushtarakisht në Kosovë në rrethana të një administrimi të dytë ushtarak në Kosovë, kur do të përsëriteshin masakrat e vitit 1945. Jugosllavët nuk kishin pritur që Shqipëria pa miqtë e mëdhenj dhe e lodhur ekonomikisht nga izolimi, do të kërcënonte aq fuqishëm, madje edhe me forcën e armëve.

Jugosllavia ishte kalbëzuar dhe quhej «E sëmura e Ballkanit». Ajo nuk e kishte shkëlqimin e dikurshëm, brenda as jashtë. Demokracitë perëndimore nuk ishin në mbështetje të saj, pavarësisht deklaratave diplomatike për unitetin dhe kohezionin e Federatës. Në një analizë të tij «Centralizimi kundrejt decentralizimit» Radovan

Vukadinoviq në dhjetor të vitit 1981 shkruante: «Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në konferencën e ekonomistëve jugosllavë në Opatia (16/17 nëntor) ishin tepër pesimistë për perspektivat ekonomike të Jugosllavisë dhe barrën e borxhit të Jugosllavisë».

Populli tashmë i zgjuar kombtarisht ishte i gatshëm ta vazhdonte intensivisht rezistencën. Ja përse akademiku serb, Qosiq klithte me dëshpërim: Kosovën e humbëm, nuk mund ta çlirojmë!

Faktor tjetër favorizues ishte solidariteti ndërkombëtar me kryengritjen. Megjithatë, «të ndryshme ishin qëndrimet e shteteve të Perëndimit nga ato të Lindjes, të shteteve skandinave nga ato të vendeve aziatiko-afrikane e qëndrimet e SHBA me ato të BS.»

Rëndësia historike e kryengritjes

Para vitit 1981 Kosova ishte në një «rrethrotullim» historik, me mundësi të vazhdimit përpara, por edhe të prapakthimit. Viti 1981, si një rubikon shqiptar e mbylli çdo mundësi të prapakthimit afatgjatë, pa le më të përhershëm. Suprimimi i autonomisë nën kërcënimin me tanke, më 1989 ishte një regres koniunktural politik, që në rrethanat historike kur ndodhi ishte tepër i vonë për të qenë i qëndrueshëm. Ukshin Hoti shkruante: «...viti 1981 është nyja, zbrëthimi i së cilës e mundëson lëvizjen e drejtë të gjërave dhe të proceseve...Të gjitha vitet i ndihmuan zhvillimit të historisë. Do të thoshim se vitet e tjera i ndihmuan akumulimit të proceseve, rritjes së kuantitetit, por kërcimin kualitativ, vetë shndërrimin e kuantitetit në kualitet, e bëri vetëm viti 1981.»

Më 1981 ndodhi demonstrimi plebishitar, me qindra mijë demonstrues, i vullnetit politik të shqiptarëve. Kryengritjen paqësore, forcat serbe e jugosllave e kthyen në ngjarje të përgjakshme. Makina shtypëse jugosllave i shërbente politikës hegjemoniste e ekspansioniste serbe, ndoshta pa kuptuar se oreksi shovinist serb nuk do të shuhej vetëm me Kosovën. Akademiku Rexhep Qosja ka thënë: «Kam shkruar shumë herë se demonstratat e vitit 1981 e kanë rikthyer çështjen e Kosovës dhe çështjen shqiptare në përgjithësi në skenën

politike botërore. Në saje të tyre është bërë ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe i çështjes shqiptare».

Viti 1981 përbën fillimin e fundit të robërimit të Kosovës, duke i hapur rrugën lirisë të shkonte sigurt drejt triumfit me Luftën Çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Gazeta amerikane «Boston Globe» e 18 qershorit 1981, pasi konstaton se më 1913 fuqitë e mëdha e bënë Shqipërinë të pavarur, por ia dorëzuan Kosovën monarkisë serbe, se Kosova është një metaforë për forcat centrifugale të historisë, gjuhës, fesë, kulturës dhe zhvillimit ekonomik, me të cilat do të ndeshet vazhdimisht Jugosllavia si një federatë e krahinave të fuqishme e të ndryshme nën një qeveri qendrore të dobët, përfundon në mënyrë profetike:

«Kosova është bota e tretë e vogël e Jugosllavisë: e varfër, krenare, e fyer dhe e padurueshme. Mënyra se si do t'ia dalin mbanë pasuesit e Titos kësaj çështjeje do t'i tregojë shumë botës mbi të ardhmen e Jugosllavisë».

Kryengritja e vitit 1981 u frymëzua dhe u përgatit për vite me radhë nga LKSH; e filluan studentët dhe në vijim u drejtua nga veprimtarët e Lëvizjes dhe patriotë të paorganizuar, duke ia ruajtur karakterin çlirimtar, demokratik e paqësor dhe duke pamundësuar manipulimin e saj armiqësor. Kryengritja ishte vepër e vetë popullit shqiptar, i cili po luftonte për të qenë i barabartë me popujt tjerë të Federatës jugosllave, për të fituar të drejtat e tij legjitime kombëtare dhe demokratike.

Ky vit sintetizues i përpjekjeve shqiptare nxori para syve të botës tërë dimensionin e çështjes së pazgjidhur shqiptare, duke filluar ndërkombëtarizimin e saj. Politika zyrtare e pushtuese e Beogradit, nuk arriti, apo nuk deshë ta kuptonte asnjëherë dialektikën e historisë së Kosovës.

Në themel të rezultateve historike të kryengritjes së vitit 1981 qëndron gjaku i dëshmorëve të saj dhe veprimtaria e Lëvizjes Kombëtare, si dhe shpirti i rezistencës së pashuar të shqiptarëve kundër robërisë.

Përfundim

Në kontekstin historik të vitit 1981, kryengritja shqiptare nuk mund të ishte në favor të pushtuesit, i cili zakonisht synon qetësi dhe jo trazira kundër tij. Një ofensivë dhe plan antishqiptar ishte përgatitur para kryengritjes dhe Serbia do ta zbatonte shumë më lehtë kundër popullit të fjetur, sesa të zgjuar.

Klasa politike zyrtare e kohës në Kosovë, pothuajse në unison e kishte pranuar kualifikimin e kryengritjes paqësore si kundërrevolucion, i cili presupozonte kundërpërgjigjen ushtarake të regjimit, si më 1945, duke masakruar dhjetëra mijë shqiptarë.

Pikërisht për shkak të atij konteksti historik dhe të rrezikut që i kanosej vetë Jugosllavisë, zotërinjtë e Beogradit hoqën dorë nga një projekt i tillë makabër. Zotërinjtë tanë në Prishtinë, nëse nuk e dinin këtë fakt atëherë, sot duhej ta kishin të qartë se Kosova mund t'i shkëputej që atëherë Serbisë e Jugosllavisë dhe madje jeta e kësaj Federate të shkurtohej edhe për 20 vjet të tjerë.

Viti 1981 vijoi deri më 1999 e 2021, duke mbajtur gjallë idealet legjitime të popullit shqiptar për të qenë i barabartë në familjen e popujve të lirë dhe në të drejtën e vet.

Serbia është e vetëdijshme që proceset historike në Kosovë nuk kthehen, por ajo e mban Kosovën si pjesë integrale të saj në kushtetutë, duke kërkuar tërësinë dhe të pamundshmen, për ta fituar pjesën.

Logjika e këtyre synimeve është një praktikë e njohur nga epoka e kolonializmit dhe dekolonizimit, prandaj duke e humbur Serbia koloninë, aspiron neokolonializmin mbi të. Mbase kjo do të ishte e mundur më 1974, por jo pas vitit 1981, e sidomos pas vitit 2008, kur Kosova u shpall shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Ajo u njoh shpejt nga shumica e vendeve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe u legjitimua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, si akt në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare.

Me Serbinë Kosova mund të ketë marrëdhënie normale, fqinjësi të mirë vetëm në kushtet e barazisë së plotë të të dy vendeve sovrane.

Shqiptarët, por edhe faktori ndërkombëtar duhet pasur parasysh nevojën e një trekëndëshi të balancës rajonale të tri kombeve, shqiptarët, serbët dhe grekët, me potencial të njëjtë a të përafërt të ruajtjes së paqes dhe të fqinjësisë së mirë e të stabilitetit të kësaj hapësire nevralgjike të Evropës.